



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Mobelland ShPK” të datës 09.12.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 04.12.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ritender” me nr. të prokurimit 616-24-8683-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Mobelland ShPK” të datës 09.12.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 04.12.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ritender” me nr. të prokurimit 616-24-8683-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Mobelland SHPK” (tutje “parashtruesi”) me datë 09.12.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 04.12.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ritender” me nr. të prokurimit 616-24-8683-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1.:

Sa i përket pretendimit të parë që nuk është dorëzuar lista sipas aneksit nr. 6 konsiderojmë që arësytimi juaj për të na eliminuar për këtë pikë nuk është i bazuar pasi që ne me tenderin tonë kemi dorëzuar listën e projekteve të realizuara në të cilën janë të përshkruara të gjitha të dhëna e kërkuara në aneksin nr. 6 sikur keni kërkuar ju. Qëllimi i këtij aneksi është që t'i ofrojë Autoritetit Kontraktues informata në lidhje me kontratat e realizuara nga ana jonë gjatë tri (3) viteve të fundit dhe është kërkuar që të kemi realizuar vlerën prej 900,000.00 €. Ne kemi dorëzuar listën e projekteve të realizuara nga ne si dhe listën e projekteve të realizuara nga anëtarit i grupit tonë. Nga lista shihet se pothuajse të gjitha projektet janë realizuar me institucione shtetërore dhe kontratat janë të publikuara në platformën e e-prokurimit. Andaj shihet qartë që ne e kemi plotësuar këtë pikë ndërsa AK me qëllim të eliminimit tonë pa të drejtë konstaton që nuk është plotësuar kjo pikë.

P.2.:

Sa i përket arësyes së dytë se nuk e kemi plotësuar kërkesën nr. 2. Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilet duhet të ketë kualifikimet shkollore të me poshtme a) Nje dizajner të interierit, b) Nje arkitekt i brendshem dhe dizajn për ambiente të gjitha me minimum 4 vite përvojë pune) Konsiderojmë që edhe këtë pikë e kemi plotësuar tërësisht pasi që kemi paraqitur z. Fahri Beqiri i cili është Dizajner i interierit dhe znj. Florijeta Beqiri e cila është arkitekte dhe dizajnere e brendshme. Me tenderin tonë kemi paraqitur diplomat e noterizuara, CV-të dhe parakontratat në emër të projektit e të dy inxhinierëve. Autoriteti Kontraktues është munduar që të arësytetojë eliminimin tonë me pretendimin se parakontratat janë në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit dhe që Ligji i punës nuk njeh parakontrata si të ligjshme por që në këtë rast ligji i punës nuk është ligj special pasi që kemi të bëjmë me procedurë të prokurimit. Andaj ligji i prokurimit është ligj special për këtë procedurë, kështu që ekzistojnë rregulla që ligji special e përjashton ligjin gjeneral sikur është në këtë rast ligji i punës. Mirëpo parakontrata është një llojë e kontratës në vehte qëllimi i së cilës është kushti që nëse krijohen rrethanat ose arrihet qëllimi për të cilën është lidhë atëherë i obligon palët që të lidhin kontratë. Prandaj në rastin tonë është lidhur parakontrata në të cilën është paraparë që nëse ne jemi fitues të këtij tenderi atëherë kjo do të konsiderohet kontratë. Në Ligjin Nr.04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve në nenin 33 janë paraparë dispozitat si vijon: 1. Parakontrata është kontratë me të cilën merret përsipër detyrimi që më vonë të lidhet kontrata tjetër kryesore. 2. Dispozitat mbi formën e kontratës kryesore vlejnë edhe për parakontratën, në qoftë se forma e parashikuar është kusht i vlefshmërisë së kontratës. 3. Parakontrata detyron, në qoftë se i përmban elementet thelbësore të kontratës kryesore.

Andaj me qenë se parakontrata të cilën e kemi dorëzuar ne për inxhinierët në fjalë i ka plotësuar të gjitha elementet e kërkuara më lartë, dëshmon që ne e kemi plotësuar kërkesën në fjalë plotësisht. Sa i përketë pvojës së znj. Florijeta Beqiri edhe me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të gabuar, pasi që znj. Beqiri ka diplomuar me datën: 16 Shtator 2019 dhe ka ofruar si dëshmi CV-n me të cilën ka dëshmuar se ka përvojë më shumë se katër (4) vite. Pra nuk është i vërtetë konstatimi i AK se ka diplomuar me 14 Dhjetor 2020 sepse kjo është data kur është lëshuar diploma nga institucioni e cila mund të lëshohet shumë më vonë me kërkesën e palës. Shih në diplomë datën e përfundimit të studimeve.

**Studimet i mbaroi më 16 Shtator 2019 në programin:
Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobileve**

Gjithashtu AK ka cekur që tek vërfikimi në ATK i arkitektës del se apj kat ëpaguara taks vetëm nga Doa ceramika e cila nuk mund të konsiderohet përvojë relevante. Në kërkesën nr. 2 në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar që punëtorët të jenë të regjistruar në ATK si dhe nuk ka kërkuar që përvoja të evidentohet nga ATK por si dëshmi ka kërkuar 2. Te dëshmohe me CV , Diplome universitare te noterizuara, kontrate te punes për

stafin. Andaj AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-s pasi që na ka eliminuar për një kërkesë të cilën nuk e ka kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Edhe për inxhinierin Fahri Beqiri sa i përketë pagës AK pretendon se nuk është respektuar paga minimale, mirëpo nga kontratat e paraqitura të punëtorëve të GOE-ik të shpërblyer me kontratë shihet se pagat janë caktuar në vlerë prej 300 € pra edhe tek këta punëtorë nuk është respektuar paga minimale e cila është 350 € sipas vendimi të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pra me këtë rast shihet qartë që Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së pasi që na ka diskriminuar duke na refuzuar neve ofertën edhe pse kemi qenë me çmim më të ulët në bazë të poentimit, ndërsa GOE-ik e ka favorizuar duke ja pranuar kontratën me pagën nën minimum të pagës minimale. Përtej kësaj konsiderojmë që A.K. ka bërë vlerësim të gabuar pasi që është bazuar në një kërkesë e cila nuk ka qenë tek kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë. Andaj edhe me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

P.3.:

Gjithashtu edhe sa i përket kërkesës nr. 3 në lidhje me certifikatën ISO 13485 2016 Autoriteti Kontraktues edhe në këtë pikë me qëllim që të na cëlinon konstaton që nuk e kemi plotësuar këtë kërkesë pasi që anëtarit të grupit tonë i mungon kjo certifikatë. Ne me tenderin tonë kemi dorëzuar certifikatën në fjalë si lider i grupit andaj kërkesa në fjalë është plotësuar tërësishtë pasi që vetëm dokumentet e përshtatshmërisë të parapara në nenin 65 të LPP-s dhe certifikatat e biznesit, kërkohet të plotësohen nga secili anëtar i grupit. Ndërsa Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Gjithashtu duke pasur parasysh se Mobelland SHPK është lider i grupit dhe artikujt për të cilët është kërkuar kjo certifikatë do të furnizohen nga ana e liderit kjo kërkesë është plotësuar në tërësi me rastin e dorëzimit të certifikatës në fjalë nga njëri anëtar i grupit. Një gjë e tillë është rregulluar me dispozitat e nenit 26 paragrafët 26.5 dhe 26.8 të RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK e plotësuar dhe ndryshuar me RREGULLORE NR.002/2024.

Sa i përketë kësaj pike pasi kemi marrë qasjen në dokumentet e tenderi dhe pasi kemi analizuar ofertën e GOE-ik të rekomanduar kemi vërejtur që certifikatat ISO 9001 2015 dhe 13485 2016 të noterizuara të paraqitura nga lideri i grupit Madekos SHPK nuk kanë validitet pasi që data e skadimit të tyre ka qenë me datën 22.10.2024. Pra edhe me këtë rast gjatë vlerësimit AK ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 7 të LPP-së pasi që për GOE-ik të rekomanduar për kontratë, konstaton që e kanë plotësuar kërkesën në fjalë edhe pse kanë dorëzuar certifikatat e skaduara.

P.4.:

Sa i përket kërkesës numër 4 në të cilën është kërkuar që OE të posedojë mjete, stabilimente dhe pajisjet makinerike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit (2 automjete pikup të regjistruara) (2 kamion 3.5 Ton të regjistruara) gabimisht është konstatuar që GOE-ik sipas dokumentacionit të dorëzuar me ofertë nuk e plotëson këtë pikë të kërkesës sepse marrëveshja e huazimit është nënshkruar me Ahmet Morinën e gjithashtu i njëjti e ka autorizuar tek noterin Operatorin Ekonomik "Mobelland" SH.P.K. që të disponojë pa kufi (ta regjistroj, qllajmëroj, shet-nënshkruaj kontratën mbi shitblerjen e automjetit, të negocioj-pranon çmimin e shitblerjes, të bëjë shkelputjen – prishjen e kontratës dhe që mund të vozit-drejtoj në Kosovë dhe jashtë Kosovës) automjetin me targa 04-552-JR. Pra për shkak që ky autorizim është i përgjithshëm dhe me afat të pa caktuar (autorizim gjeneral) është i vlefshëm pranë çdo institucioni, prandaj nuk ka nevoj që t'i referohet numrit të prokurimit siç ka cekur AK. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është dashur që të kërkoj sqarim në bazë të nenit 72 të LPP-s pasi që ne kemi pasur në dispozicion edhe pajisjet e anëtarit të grupit Interlab SHPK të cilat e plotësojnë këtë kërkesë. Por sikur kemi cekur edhe më lartë AK vetëm është munduar që të gjejë pretekste që të na cëlinon me qëllim të shpërblimit me kontratë Grupin e paracaktuar Madekos & Wood Corporation.

P.5.:

Edhe sa i përketë kërkesës nr. 5 me të cilën është kërkuar që O.E. të ketë kryer vlerësimin e rrishtit për të gjitha pozitat konform ligjit 04 L-161. Ne kemi qenë në procedurë të ri-vlerësimit të rrishtit para datës së dorëzimit të ofertës si dhe anëtarit i grupit tonë e ka pasur vlerësimin e rrishtit me afat. Por që Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar sqarim në bazë të nenit 72 të LPP-s me ç'rast do ta kishim dërguar raportin e vlerësimit të rrishtit i cili do të plotësohte kërkesën në fjalë në emër të grupit tonë. Andaj me këtë rast AK ka shkelur dispozitat e nenit 72 të LPP-së.

P.6.:

Sa i përketë arsyeve të 6 se kinse ne nuk e kemi plotësuar kërkesën nr. 6 Autorizimi i prodhuesit ose dilerit të autorizuar dhe Katalogu Broshura e prodhuesit per Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 (per keto pozicione lejohet ofertimi me dimensione +-5%) ne me tenderin tonë kemi dorëzua deklaratën me shkrim me të cilën kemi deklaruar se ne kemi fabrikë prodhuese dhe se të gjithë artikujt e kërkuar i prodhojmë vetë apo e bëjmë importin dhe montimin e tyre. Pra ne nuk kemi si ta autorizojmë vetën pasi që ne jemi vetë prodhues dhe një gjë e tillë mund të vërtetohet shumë lehtë në certifikatën e biznesit tonë në të cilin e kemi kodin për prodhimin e pajisjeve mjekësore dhe dentare **3250**.

P.7.:

Edhe sa i përketë kësaj pike Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së pasi që ka përdorur standarde të dyfishta. Nga katalogu i paraqitur nga GOE-ik i paracaktuar për kontratë shihet se ky grup nuk ka ofruar katalogun për Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 sikur është kërkuar në dosje të tenderit por ka ofruar katalogje vetëm për pozicionet 3.12; 4.49; 4.50; 4.51; 4.52; 4.54; 4.55; 4.58 dhe 4.63 Pra është kërkuar katalog për pesëmbëdhjetë (15) artikuj ndërsa GOE-ik i paracaktuar ka ofruar katalog për nëntë (9) artikuj. Ndërsa ne edhe pse kemi dorëzuar katalogun për të gjithë artikujt e kërkuar në tender, nuk e merr për bazë. Pra këtu shihet qartë diskriminimi.

Lidhur me pretendimet ankimore nr. 1, 2, 4, 5 dhe 6, është gjetur se të gjitha arsyet eliminuese të konstatuara nga komisioni vlerësues janë të sakta në tërësi. Rrjedhimisht pretendimet ankimore në këto pika janë të pabazuara.

Më konkretisht lidhur me pretendimin nr. 1 është gjetur se arsyeja eliminuese i referohet kërkesës së DT të formuluar si vijon: *"Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit..."*. Pra në DT është kërkuar shprehimisht që të plotësohet aneksi 6 i DT. Në rastin konkret nuk është kontestuese as për parashtruesin që asnjëri nga anëtarët e GOE nuk e kanë plotësuar këtë aneks të dosjes së tenderit. Prandaj arsyeja eliminuese është e saktë ndërsa pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 2 është gjetur se arsyeja eliminuese i referohet kërkesës së DT të formuluar si vijon:

2. Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilet duhet të ketë kualifikimet shkollore të mëposhtme a) Nje dizajner të interiorit, b) Nje arkitekt I brendshem dhe dizajn per ambiente të gjitha me minimum 4 vite pervojë pune)	2. Të deshmohen me CV , Diplome universitare të noterizuara, kontrate të punës për stafin
--	---

GOE ka prezantuar z. Fahri Beqiri si dizajner të interiorit ndërsa znj. Florijeta Beqiri si arkitekt të brendshëm dhe dizajn. Fillimisht duhet cekur se në DT është kërkuar shprehimisht kontratë e punës për stafin e kërkuar. Në anën tjetër parashtruesi ka dorëzuar parakontrata. Nuk qëndron argumenti i parashtruesit sipas të cili parakontrata është përpiluar në përputhje me nenin 33 të LMD pasi që në rastin konkret nuk është kërkuar kontratë detyrimore në kuptim të LMD por kontratë e punës në kuptim të ligjit të punës. Mbi të gjitha, për znj. Florijeta Beqiri janë kërkuar së paku 4 vite përvojë e punës profesionale. Mirëpo e njëjta ka dorëzuar diplomën e studimeve themelore ku evidentohet se e njëjta ka diplomuar me datë 14 dhjetor 2020 që nënkupton se nuk ka pasur mundësi të krijoj 4 vite të përvojës së punës profesionale përderisa hapja është bërë në nëntor të vitit 2024 pra ende pa u mbushur 4 vite kalendarike. Absolutisht nuk qëndron argumenti i parashtruesit ku thuhet se duhet të merret parasysh data e përfundimit të studimeve dhe jo data e diplomimit. Kjo për arsye se studimet mund të përfundojnë në një datë të caktuar mirëpo titulli përkatës akademik fitohet ekskluzivisht në momentin e diplomimit. Prandaj konstatimi i komisionit vlerësues dhe arsyeja eliminuese është e saktë ndërsa pretendimi ankimor i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 4 është gjetur se arsyeja eliminuese i referohet kërkesës së DT të formuluar si vijon:

4. OE të posedojë mjete, staibilmente, dhe pajisjet makinerike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit (2 automjete pikup të regjistruara), (2 kamion 3.5 Ton të regjistruara).	4. Librezat për autopikap, kamion të ofrohen, për maqinat të ofrohen DUD-at (në rast kur OE ka marrëveshje për shfrytëzim të autopikapave dhe kamionit të ofrohen marrëveshjet e noterizime me të dhenat e aktivitetit të ketij prokurimit)
--	--

Në rastin konkret parashtruesi ka dorëzuar një marrëveshje për marrje të qirasë së automjeteve me qiradhënësin mirëpo kjo marrëveshje nuk është e noterizuar. Parashtruesi e ka dorëzuar një autorizim (jo deklaratë noteriale për noterizim të marrëveshjes së qirasë) mirëpo autorizimi i cili është i datës 27.10.2023 nuk i referohet fare as marrëveshjes për qira dhe as aktivitetit të prokurimit për të cilin po bëhet fjalë. Prandaj arsyeja eliminuese është e saktë ndërsa pretendimi ankimor i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 5 është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar vlerësimin e riskut pa afat (më të vjetër se 2 vite) dhe ky fakt nuk kontestohet nga parashtruesi. Prandaj arsyeja eliminuese është e saktë ndërsa pretendimi ankimor i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 6 është gjetur se arsyeja eliminuese i referohet kërkesës së DT të formuluar si vijon:

6. Autorizimi i prodhuesit ose dilerit të autorizuar dhe Katallogu Broshura e prodhuesit per Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 (per keto pozicione lejohet ofertimi me dimensione +-5%)	6. Kopja e Autorizimit me te dhenat e tenderit, Kopja e Katallogut Broshurave e prodhuesit per Poz.Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 (per keto pozicione lejohet ofertimi me dimensione +-5%)
--	--

Në kërkesën për rishqyrtim parashtruesi pretendon se është vet prodhues i pajisjeve mjekësore medicinale. Prandaj i njëjti ka dorëzuar një katalog të vulosur dhe nënshkruar nga vet parashtruesi. Në anën tjetër nga certifikata e biznesit të parashtruesit rezulton që aktiviteti primar dhe sekondar i parashtruesit është prodhimi i mobilieve të kuzhinës dhe mobilieve të tjera megjithëse një nga kodet e veprimtarisë është edhe prodhimi i instrumenteve dhe pajisjeve mjekësore dhe dentare në mesine 22 aktiviteteve të përgjithshme të parashtruesit. Nga ky këndvështrim mund të thuhet që pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar. Mirëpo duke marrë parasysh të gjeturat lidhur me arsyet tjera eliminuese dhe faktin që oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme, ky konstatim nuk mund të ndikoj në epilogun e këtij vendimi.

Lidhur me pretendimin nr. 3 është gjetur se kërkesa për ISO të cilës i referohet arsyes eliminuese është formuluar në DT si kërkesë për kapacitetin teknik dhe profesional. Në anën tjetër nuk është kontestues fakti që së paku njëri anëtar i GOE i ka dorëzuar certifikatat ISO të kërkuara me DT. Në kuptim të nenit 26.5 të RRPP kjo kërkesë e DT duhet konsideruar si e përmbushur. Rrjedhimisht arsyeja eliminuese është e pasakta ndërsa pretendimi ankimor është i bazuar. Megjithatë duke marrë parasysh të gjeturat lidhur me arsyet tjera eliminuese dhe faktin që oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme, as ky konstatim nuk mund të ndikoj në epilogun e këtij vendimi.

Lidhur me pretendimin nr. 7: të drejtuar kundër tenderuesit tjetër në këtë aktivitet të prokurimit, duhet sqaruar se parashtruesi përderisa vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të dëshmoj asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të*

prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, përderisa parashtruesi për vete ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, dhe nuk ka arritur që të dëshmojë të kundërtën as me këtë kërkesë për rishqyrtim, atëherë i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë. Megjithatë duhet cekur se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar sipas vlerësimit të komisionit vlerësues është ofertë tërësisht të përgjegjshme. Prandaj rekomandimi për dhënie të kontratës nga komisioni vlerësues është në përputhje të plotë me kriteret e dhënies së kontratës sipas dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera, edhe po të ishte palë e interesuar parashtruesi në raport me këto pretendime, sërish pretendimet e tij janë të pabazuara.

Sa i përket pikës së pretendimit nr. 7 lidhur me certifikatat ISO të tenderuesit të rekomanduar, duhet cekur se anëtari i GOE ka dorëzuar certifikatat me validitet dhe të njëjtat janë të mjaftueshme për të konsideruar si të përmbushur kërkesën e DT. Kërkesa për ISO është formuluar në DT si kërkesë për kapacitetin teknik dhe profesional. Prandaj në kuptim të nenit 26.5 të RRPP kjo kërkesë e DT duhet konsideruar si e përmbushur nëse njëri anëtar i GOE i dorëzon dëshmitë e kërkuara dokumentare. Rrjedhimisht kjo pikë e pretendimit ankimor është e pabazuar.

Sa i përket pikës së pretendimit nr. 7 se pajisjet sipas katalogut dhe autorizimit të tenderuesit të rekomanduar nuk janë në përputhje me paramasën, as kjo pikë e pretendimit ankimor nuk qëndron pasi që në katalogun e dorëzuar evidentohen të gjitha specifikat teknike në pozicionet përkatëse sikurse janë kërkuar me DT.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme ndërsa të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara me përjashtim vetëm të pretendimit nr. 3 që është gjetur si e bazuar dhe pretendimit nr. 6 që është gjetur si pjesërisht e bazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.12.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.